



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 83-të të mbajtur më 27.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-4421/1 të vitit 2021, ,HIDHET POSHTË .

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka kompetencë për të vepruar në rastin e lëndës për arsye se personat e paraqitur në denoncim janë duke zhvilluar procedura juridike pranë gjykatës kompetente.

Lënda me numër 12-4421/1 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga në parashtrues i njohur, _____, _____, _____, _____, _____ dhe _____, banues ne një pallat banimi ne Blv. _____ nr. --- nga _____ më datë 01.11.2021 është dorëzuar denoncim për pakënaqësi në procedurë gjyqësore, pasi është bërë padi nga personi _____ dhe është formuar lënda me numër 12-4421 i vitit 2021.

Gjegjësisht, për shkak të rrënimit të konstruksionit të kulmit në objektin në adresën e treguar, Blv. _____ nr. _____, _____, banesa në pronësi të personit _____ ka pësuar vazhdimisht dëmtime nga ndikimet e jashtme. Pas përpjekjes së pasuksesshme për të marrë pëlqimin e banuesve të pallatit dhe të kryej rikonstruksionin, dhe sipas udhëzimeve të marra nga Komunës _____, që nëse nuk e siguron pëlqimin e banuesve të pallatit, ka të drejtë të i drejtohet Gjykatës Themelore Shkup 2 me kërkesë për sigurimin e provës, personi _____

----- ka vepruar sipas udhëzimeve të pranuar dhe ka dorëzuar propozim për sigurimin e provave në Gjykatën Themelore Shkup 2.

Pas urdhrit të dhënë nga gjykata, ekspertizës së përgatitur dhe marrjes së ofertave dhe kryerjes së rikonstruksionit, janë dorëzuar fatura për punimet e kryera nga kontraktori, të cilat janë paguar plotësisht nga personi -----.

Por më vonë ai ka ngritur një padi dhe ka kërkuar nga banuesit e pallatit, fqinjët dhe ata që preken drejtpërdrejt nga vendndodhja e banesave të tyre, si dhe personat që paraqesin këtë denoncim në KSHPK, të marrin pjesë në proporcion me kostot e përcaktuara dhe të bëra.

Procedura gjyqësore është zhvilluar, për të cilën Gjykata Themelore Shkup 2 ka nxjerrë aktgjykimin nr. -----/--- e cila rrëzon si të pabazuar padinë e banuesit e pallatit të tyre kundër parashtruesve të kësaj kërkesë në KSHPK. I pakënaqur me aktgjykimin, banuesi i pallatit u ankua në Gjykatën e Apelit, ku u zhvillua procedura për një çështje të regjistruar me nr. -----/--- e njëjta është miratuar dhe është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës themelore, me të cilin të paditurit dhe parashtruesit e kërkesës në KSHPK janë obliguar t'i paguajnë dëmshpërblim paditësit - ----
----- në emër të riparimit dhe rikonstruksionit të çatisë së objektit të banimit.

Të pakënaqur me këtë Aktgjykim të Gjykatës së Apelit, parashtruesit e denoncimit kërkojnë që KSHPK-ja të vendosë përgjegjësi.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të lëndës, KSHPK-ja ka konstatuar se në rastin bëhet fjalë për vendime të gjyqtarëve dhe për të cilat vendime KSHPK nuk ka bazë për rishqyrtim sepse procedura nuk ka përfunduar dhe ende është duke u zhvilluar para gjykatave më të larta kompetente.

Në bazë të sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Dorëzuar deri:
- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: Mr. K.Z

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОРЕ
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
Нёнкрыетар
Katica Nikolovska

